**Akti i Themelimit**

**AK CONSTRUCTION SHPK**

**Tiranë-Shqipëri**

**Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)**

Sot, me datë 21. 03. 2024, të nënshkruarit:

**Z. Hergys Rreli**, shtetas shqiptar , i biri i Naim-it,i datelindjes 24.09.1981, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin me Nr. Personal I10924042Q

**Z.Klajdo Alibehaj**, i biri i Skender-it ,i datelindjes 03.03.1988, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin me Nr. Personal I80303107K.

Me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "(Ligji i Shoqërive) kanë vendosur të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **AK CONSTRUCTION** ("Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

**Neni 1.** <u>**Emri dhe forma ligjore**</u>

1.1 Emri i shoqërisë do të jetë **AK CONSTRUCTION** ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", i cili përfaqëson formën ligjore të saj.

1.2 Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(Ligji i Shoqërive).

**Neni 2.** <u>**Selia dhe kohëzgjatja**</u>

2.1 Selia e Shoqerise do te jete ne adresen : Tirane, Rr "Fatmir Haxhiu", shkalla nr.4, ap 25.. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin

Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

Neni 3. <u>Objekti i veprimtarisë</u>

3.1 Shoqëria ka për objekt:

1.Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, ndertimi i ambjenteve dhe gjithe infrastrukturen e nevojshme ne fushen e sportive, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, Ujrave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitese, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe 9do ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur.
2.Ne fushen e minierave shoqeria do te kryeje: Studimin, zbatimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te minierave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytezimin e minierave publike dhe private per te tera llojet e mineraleve, shfrytezimin e burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara.
3 .Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere, per realizimin e hotelerise, fshate turistike, qendra turistike e te tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi te shitjeve te konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industrial e te tjera te kesaj natyre; Ne fushen e agroturizmit dhe hotelerise do te ushtroje sipermarrjen ndertuese dhe zhvilluese . Krijimin e agjencive turistike e te tjera.
Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave si dhe tranzitimin e tyre pergjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor,

teleferik etj. Shoqeria gjithashtu do te kryeje dhe duke mos u kufizuar vetem ne, aktivitetet e meposhtme: - Ngarkim dhe shkarkim te anijeve; Pritje dhe levrim te ngarkesave nga dhe per ne anije; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim, dhe levrim i ngarkesave nga dhe neper anije.- Sipermarrje dhe realizimi i c;faredolloj aktiviteti te ligjshem lidhur dhe ne sherbim te ngarkimit dhe shkarkimit te anijeve ne 9do vendankorim, ne porte. - Sipermarrje, pergatitje dhe realizim i procesit te ngarkimit dhe te shkarkimit te konteniereve, te mjeteve te tjera transportuese, te anijeve, ne interes dhe per llogari te pronarit te anijes, pergjithesisht te mjetit transportues, ne interes dhe per llogari te pronarit te ngarkeses dhe/ose te porositesit te automjeteve/ trenit, anijes apo porositesve te tjere te ligjshem.-Sipermarrje dhe realizim i ndermjetesimit dhe transportit, ngarkimit dhe shkarkimit te mallrave me tren e automjete ne intere's dhe per llogari te shoqerise dhe te Porositesve, persona te trete.

Neni 4. <u>Kapitali fillestar dhe ndarja e tij</u>

4.1 Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 100 000 (njëqind mijë) lekë, ku pjesëmarrja e secilit Ortak të Shoqërisë në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

Z.Klajdo Alibehaj zotëron një kuotë të barabartë me 51% (pesedhejte e nje përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, ekuivalente me 51 000 (pesedhjetë e nje mijë) Lekë vlerë nominale.

Z. Hergys Rreli zotëron një kuotë të barabartë me 49% (dyzet e nente përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, ekuivalente me 49.000 ( dyzet e nente mije ) Lekë vlerë nominale.

Neni 5. <u>Organet drejtuese dhe Administrimi</u>

5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

5.2 Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë:

| Të dhënat e identifikimit | Specimeni i nënshkrimit |
| --- | --- |
| Z.Klajdo Alibehaj i biri i Skender-it ,i datelindjes 03.03.1988, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin me Nr. Personal I80303107K. | |

**Neni 6.** <u>Të tjera</u>

6.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

6.2 Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërisë, sot më datë 21. 03. 2024 në gjuhën shqipe, në katër kopje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQERISË

Z. Hergys Rreli

Z. Klajdo Alibehaj